IPOL
BALKAN POLICY INSTITUTE

Fletushka e Politikave

Mars 2010
Nr. 01

PROKURIMI PUBLIK: TË NDRYSHOHET LIGJI PËR TË PARANDALUAR KORRUPSIONIN

Më 26 Mars, Instituti Ballkanik i Politikave (IPOL) publikoi analizën e politikave për prokurim publik "Analizë për ligjin për prokurim publik në Kosovë nr 02/l-99", në kuadër të projektit: "Prokurimi publik, konkurrenca dhe mbrojtja e konsumatorit", projekt ky i mbështetur nga Fondacioni SOROS. Kjo analizë përmban rekomandime për ndryshimin e ligjit për prokurim publik në Kosovë.

Prokurimi publik ka qenë një nga fushat më të kritikuara në Raportin e Progresit 2009 të Bashkimit Evropian për Kosovën. Ky raport kishte konkluduar se gjendja e prokurimit publik ishte përkeqësuar. Ligji ekzistues nuk përputhet me standardet Europiane të prokurimit publik. Nuk ka mbikëqyrje të kontratave dhe monitorim të implementimit të tyre. Çështja më problematike është rritja e tenderimit njëburimor nga 50 milionë Euro në 164 milionë Euro brenda një viti.

Po ashtu, raportet e auditimit të kualifikuara nga Zyra e Auditorit Gjeneral tregojnë për shumë parregullsi. Në të njëjtën kohë ekziston një perceptim i pranisë së madhe të korrupsionit në Institucionet e Kosovës. Këto dhe çështja problematike e punës jo kualitative nga ana e operatorëve ekonomikë janë si bazë për këtë analizë.

Duke pasur parasysh procesin e integrimeve Europiane dhe rëndësinë që ka lufta kundër korrupsionit në këtë proces, ne i kemi bazuar rekomandimet tona në direktivat Europiane. Adoptimi i këtyre rekomandimeve do të ndihmonte në parandalimin e korrupsionit. Këtu kemi propozuar që ndryshimet e ligjit të jenë të bazuara në Direktivat 2004/17 dhe 2004/18 për Prokurim Publik të Unionit Evropian. Rekomandimet janë të bazuara në kapacitetet momentale të cilat i kanë institucionet kosovare.

NGJARJET E ARDHSHME:

Publikimi i raportit vazhdues të raportit të parë mbi punën e EULEX-it.

Tryezë e rrumbullakët mbi konkurrencën dhe mbrojtjen e konsumatorit.

PUBLIKIMET TONA:

EULEX: Në kërkim të identitetit (Raporti i vlerësimit ti punës njëvjeçare të EULEX-it).

Analizë për ligjin e prokurimit publik...

Reforma e pushtetit lokal dhe sistemi zgjedhor.

PROJEKTET TONA:

Konkurrenca, prokurimi publik dhe mbrojtja e konsumatorit

Ndërtimi i komunave të reja

Raporti krahasues mbi Ballkanin Jugor

Për ne: Instituti Ballkanik i Politikave punon për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe qeverisjen e mirë përmes politikëbërjes pragmatike që funksionon për mirëqenien e qytetarëve.
Si të na gjeni: Instituti Ballkanik i Politikave (IPOL), Rr. Qamil Hoxha Nr.4/3, Prishtinë, Kosovë
Tel / +381 (0)38 220 552 **www.policyinstitute.eu**